

2. N. Vidurrera
30.4.2020

2079
30.04.20



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK

Nr. 496/13 Prot.

Tiranë, më 28 04 2020

Lënda: Dërgim i Udhëzuesit për "Administratën/punët në zyrë dhe terren (COVID-19)" dhe Udhëzuesi për "Qëndrimin dhe levizjen në shkollë (COVID-19)"

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Bazuar në Urdhërat e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi parandalimin e përhapjes së COVID-19 dhe Ligjit Nr.15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive".

Instituti Shëndetit Publik ka hartuar udhëzuesit si më poshtë:

- 1- UDHËZUESIN PËR ADMINISTRATËN/PUNËT NË ZYRË DHE TERREN (COVID-19)
- 2- UDHËZUESIN PËR QËNDRIMIN DHE LEVIZJEN NË SHKOLLË (COVID-19)

DREJTOR
Albana FICO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK

Nr. 496/11 prot.

Tiranë, më 29.04.2020

UDHËZUES

PËR

“ADMINISTRATËN/ PUNËT NË ZYRË DHE TERREN (COVID-19)”

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të orientojë dhe t’u rekomandojë drejtuesve të administratës dhe punonjësve praktikantët e duhura të kufizimit të përhapjes të COVID-19, duke sjellë zvogëlimin e transmetimit midis punonjësve, për të ruajtur vijimësinë e punës dhe krijimin e një ambienti pune të shëndetshëm.

Zbatimi i këtij udhëzimi siguron:

1. Reduktimin e transmetimit të infeksionit midis punonjësve;
 2. Sigurimin e një ambienti të shëndetshëm në punë;
 3. Vijimësinë normale të aktivitetit të punës.
- Të sigurohen në mënyrë të vazhdueshme elementët e higjienës ku përfshihen: sapun i duarve, dezinfektantët me bazë akooli që kanë të paktën 60% alkool, letër të pastrimit të duarve ose peshqir me një përdorim për pastrimin e sipërfaqeve dhe sigurimi i koshave të mbyllur për eliminimin e mbetjeve;
- Të krijohen kushte të cilat do të lejojnë një kombinim të punës nga shtëpia, orë fleksible të orarit të zakonshëm të punës, të cilat mundësojnë të rritet distanca fizike nga një punonjës në tjetrin ose / dhe krijojnë mundësinë e këtyre punonjësve të jenë në distancë 2 metra nga njëri – tjetri;
- Të aplikohet larja e duarve dhe/ose përdorimi i dezinfektantëve kur ato janë të ndotura ose pas heqjes së maskës dhe dorezav; *(Mbështetur në Udhëzuesin e MSHMS mbi hapat dhe mënyrën e larjes së duarve)*
- Punonjësit NUK duhet të përdorin mjetet e njëri - tjetrit dhe postet e ndërsjellta të punës;

- Punonjësit duhet të respektojnë praktikat e etiketës respiratore, kollitjes e teshtitjes;
- Punonjësit duhet të respektojnë masat e distancimit social dhe fizik të cilat do të kryhen sipas një plani të vetë institucionit duke respektuar distancën 2 metra;
- Institucionet duhet të kryejnë pastrimin e vazhdueshëm të sipërfaqeve dhe elementëve të tjerë të vendit të punës. Është e nevojshme që produktet dezinfektuese të kenë përqindjen, metodën e aplikimit dhe kohën e kontaktit të saktë, si dhe përdorimi i tyre duhet bërë duke përdorur mjetet e mbrojtjes personale; *(Mbështetur në Udhëzuesin e MShMS-së për pastrimin e mjedisit në objektet (jo të kujdesit shëndetësor) e ekspozuar ndaj COVID-19)*
- Duhet të kryhet dezinfektimi i mjedisit, pastrimi përpara hapjes dhe pas mbylljes së procesit të punës, sidomos i tavolinave, telefonave, tastierave të kompjuterave dhe çdo hapësirë ku ka patur kontakt me duar, si dhe ajrimi sipas mundësisë minimalisht 3 herë në ditë;
- Korridoret të pastrohen çdo dy orë;
- Tualetet të pastrohen e dezinfektohen çdo 30 minuta;
- Dorezat e çdo zyre dhe mjedisi pune si dhe parmaket e shkallëve, pastrohen dhe dezinfektohen çdo 30 minuta;
- Nëse në një institucion një nga punonjësit është apo ka pasur kontakt të ngushtë me një person pozitiv COVID-19, duhet të qëndrojnë në vetëkarantinim dhe të njoftojë mjekun e familjes dhe drejtuesin e institucionit;
- Punonjësit që kanë shenja klinike DUHET të qëndrojnë në shtëpi, të vetëkarantinohen, të monitorojnë shenjat klinike dhe për çdo shqetësim të njoftojnë mjekun e familjes ose 127;
- Nëse ka një rast të dyshuar me COVID-19 në institucion duhet të njoftohet MENJËHERË NJVKSH-ja dhe mjeku përkatës i familjes;
- Punonjësit duhet të vendosin maska mbrojtëse ose mbrojtëse të fytyrës prej tekstili (maskë) të cilat duhet të lahen në 60 gradë dhe të hekurosen, si dhe shami letre për higjienën e hundëve;
- Të minimizohet kontakti midis qytetarëve dhe punonjësve duke i zëvendësuar takimet fizike me komunikime online;

- Në çdo institucion duhen të jetë e vendosur në vend të dukshëm rregullorja mbi tërësinë e masave të minimizimit të transmetimit të COVID-19;
- Punonjësit e administratës për udhëtimet në terren duhet të respektojnë rregullat e distancimit fizik gjatë udhëtimit dhe në terren;
- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor duhet të kryejë inspektimin sistematik për vlerësimin e zbatimit të masave përkundrejt penaliteteve në fuqi.

DREJTOR
Albana FICO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETTIT PUBLIK

Nr. 496/12 Prot.

Tiranë, më 29.04.2020

**UDHËZUES
PËR
"QËNDRIMIN DHE LËVIZJET NË SHKOLLË (COVID-19)"**

I. PËR NXËNËSIN

Hyrja dhe dalja nga ambientet e shkollës

- Orari për hyrjen e nxënësve në shkollë rregullohet sipas një grafiku, hartuar nga drejtoria e shkollës dhe nën monitorimin e mësuesve të kujdestarisë ditore/javore.
- Nxënësit paraqiten në shkollë duke respektuar me përpikëri orarin e komunikuar nga mësuesi kujdestar i tyre.
- Nxënësit hyjnë në shkollë pasi janë vendosur në radhë një nga një, me largësi 2 metra.
- Nxënësi që ka simptoma të ngjashme apo temperaturë përpara ardhjes në shkollë, njofton mësuesin kujdestar, i cili, në bashkëpunim me mjekun e shkollës ose atë të familjes, verifikon nëse nxënësi është i sëmurë apo jo.
- Justifikimi i mungesës bëhet vetem nga mjeku i familjes.
- Personi përgjegjës i stafit të shkollës, i caktuar nga drejtori, duhet të kryejë vlerësimin për çdo nxënësi si më poshtë vijon:
 - Matje të temperaturës me termometër digjital;
 - Sprucim me alkool 60% ose dezinfektantë të tjerë në duar;
 - Duhet të kontrollohen të gjithë nxënësit që të jenë të pajisur me maskë një përdorimshe ose mbrojtëse të fytyrës prej tekstili (maskë) të cilat duhet të lahen në 60 gradë dhe të hekurosen, si dhe shami letre për higjenën e hundëve;
- Sipas mundësive mund të vendosen vaska me solucion dezinfektues me bazë të klorit aktiv, për dezinfektimin e shuajve të këpucëve përpara hyrjes në ambientet e brendshme të shkollës.
- Nuk lejohet që nxënësit të dalin nga godina dhe të rikthehen përsëri në të, brenda ditës.
- Dera e shkollës do të qëndrojë e mbyllur, ndërsa dritaret e klasave ku zhvillohet procesi mësimor, do të qëndrojnë të hapura për të krijuar ajrosjen e nevojshme brenda tyre.
- Lejohet vetëm një hyrje dhe një dalje në ndërtesën e shkollës.

- Dalja nga ambientet e shkollës do të bëhet sipas rregullave, duke ruajtur distancimin social dhe fizik si me lart (2 metra), nën mbikëqyrjen e mësuesve kujdestarë dhe të punonjësve të tjerë të shkollës.
- Nxënësit që nuk zbatojnë këtë rregullore, trajtohen me masë disiplinore nga Komisioni i Etikës dhe i Sjelljes.

Qëndrimi dhe mësimi në klasa

- Gjatë procesit mësimor, mësuesi qëndron në klasë duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mësuesit e tjerë, në 2 metra.
- Brenda klasës, nxënësit qëndrojnë të ulur në banka të paktën 2 metra larg njëri-tjetrit. Në klasat ku kjo nuk është e mundur, nxënësit do të ndahen në klasa të tjera.
- Mësuesit sigurohen që në klasë të gjithë të jenë të pajisur me maskë dhe t'i mbajnë rregullisht ato.
- Nxënësit ndalohen të dalin nga klasa gjatë orëve të mësim përveç rasteve kur i duhet të përdorin tualetet. Në këtë rast nxënësi duhet të shoqërohet.
- Çanta me librat e nxënësit mbahet në shkollë (nxënësit nuk e marrin çantën nga shtëpia në shkollë dhe anasjellas).
- Kur është e mundur, praktikohet mësimi në ambient të hapur (oborr shkolle), duke respektuar largësinë dhe rregullat e mësipërme.
- Nuk lejohet ushqimi në klasë.

Lëvizjet në mjediset e brendshme të shkollës

- Lëvizja e nxënësve në klasa, laboratorë, palestra dhe nëpër korridore duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë që çdo zonë të ketë numrin më të vogël të individëve që lëvizin në të. Kjo do të thotë, p.sh., nxënësit e klasës I^a do të hyjnë vetëm në sallën e përcaktuar për nxënësit e kësaj klase, do të përdorin vetëm tualetin në korridorin ku ndodhet klasa e tyre, pa u takuar asnjë moment me nxënës të klasave të tjera.
- Rregullat për lëvizjen e nxënësve duhet të jenë të afishuara në ambientet e klasave dhe në korridore.
- Nuk lejohen qëndrimet në korridore.
- Nxënësit të mbajnë largësinë minimale 2 metra nga njëri-tjetri kur lëvizin në korridore.
- Komunikimi, në rast nevojë, i nxënësit me drejtuesit, sekretarinë dhe stafin mësimor, do të kryhet nëpërmjet mësuesit përgjegjës të katit, duke respektuar distancimin social e fizik dhe rregullat e tjera të përcaktuara me lart. Mund të jetë edhe nëpërmjet telefonit apo kompjuterik, kur nxënësi nuk ndodhet në klasë.
- Nuk do të përdoren materiale të printuara, përveç rasteve kur nxënësit kanë libra të cilat i mbajnë tek sendet personale, ose në shtëpi.

- Nuk do të përdoren sende personale të panevojshme për procesin mësimor.
- Nuk do të kontaktohen personat që mund të jenë të pranishëm në mjediset e shkollës.

Kujdesi për higjiën

- Nxënësit të ndërgjegjësohen dhe të mbahen në komunikim të vazhdueshëm për rëndësinë që ka distancimi fizik dhe higjiena personale në ambientet brenda dhe jashtë shkollës, nëpërmjet mesazheve sensibilizuese të shpërndara nga ekipi mjekësor dhe shërbimi psiko-social i shkollës.
- Nxënësve duhet t'u flitet çdo ditë për rregullat e higjiënës, larjen e duarve, mënyrën e kollitjes dhe teshtitjes.
- Çdo nxënës në shkollë duhet të lajë duart pas çdo veprimi që mund të përbëjë rrezik për përhapjen e virusit: prekja e hundës, syve, gojës, etj.
- Duhet të sigurohen: uji i rrjedhshëm, sapuni i lëngshëm, letra për fshirjen e duarve dhe xheli me përmbajtje alkooli 60%, në ambientet e shkollës.
- Gjatë qëndrimit në ambientet e shkollës, çdo individ duhet të mbajë detyrimisht maskë.
- Dritaret duhet të mbahen të hapura, ose të paktën klasat të ajrosen 5-6 herë gjatë kohës së mësimi.
- Klasat duhet të kenë aq nxënës sa lejojnë distancimin 2 metra nga njëri nxënës tek tjetri. Janë të ndaluara takimet dhe mbledhjet ballë për ballë në ambientet e shkollës.
- Nëse nxënësi manifeston gjendje stresi dhe ankthi, ai i drejtohet shërbimit psiko-social të shkollës nëpërmjet mësuesit kujdestar dhe "Këndit të psikologut" online pranë DRAP-së .
- Në një klasë apo sallë laboratorit të mos qëndrojnë më shumë nxënës sesa mund të qëndrojnë në atë mjedis, duke respektuar distancimin social dhe fizik.
- Aktivitetet jashtëshkollore, sportive e artistike në grup janë të ndaluara.
- Të jenë të afishuara në të gjitha ambientet e shkollës postera mbi masat e parandalimit të infeksionit COVID-19 dhe postera me mesazhe të qarta dhe të thjeshta.
- Të vendosen postera të veçantë për mënyrën e larjes së duarve.
- Në hyrje dhe në dalje të ambienteve të shkollës, rekomandohet të vendoset një higjenizues për duart në trajtë solucioni me përmbajtje aktive të alkoolit 60%, i cili duhet të jetë gjatë gjithë kohës i pranishëm
- Të kryhet dezinfektimi i çdo klase, çdo ditë. Pas përfundimit të procesit mësimor, të kryhet pastrimi i sipërfaqeve dhe orendive me lëndë dezinfektuese.
- Në fund të çdo dite duhet të planifikohet dhe kryhet edhe denzifektimi i mjediseve të përbashkëta të shkollës.
- Do të pranohen në ambientet e shkollës vetëm nxënësit apo prindërit (në rastet e nxënësve të ciklit fillor) që do të firmosin rregulloren mbi parandalimin e përhapjes së COVID-19.
- Përpara se të rifillojnë mësimin në ambientet e shkollës, sipas rregulloreve të reja për parandalimin e përhapjes së COVID-19, nxënësit duhet të plotësojnë Formularin e

Vetëdeklarimit për situatën e tyre shëndetësore dhe të familjarëve të tyre, e cila shërben për të hetuar paraprakisht mundësinë e një vatre infeksioni COVID-19.

- Nxënësit që nuk zbatojnë rregulloren, trajtohen me masë sipas rregullores së shkollës.

II. PËR MËSUESIN

- Mësuesi paraqitet në shkollë në orën e përcaktuar nga drejtoria, përpara ardhjes së nxënësve.
- Mësuesit e kujdestarisë ditore/javore paraqiten në shkollë në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës.
- Staf i mjekësor i shkollës (mjeku/infermierja e shkollës), ose personeli i shkollës i caktuar nga drejtori dhe i trajnuar për veprimet e mëposhtëme, kryen për çdo nxënës procedurën si më poshtë:
 - Mat temperaturën me termometër digjital.
 - Spërkat solucion dezinfektues me përmbajtje 70% alkooli në duart e nxënësve dhe të stafit.
 - Kontrollon nëse çdo nxënës është i pajisur me maskë.
- Mësuesi mban gjatë orarit zyrtar maskën, dorezat dhe solucione dezinfektuese.
- Gjatë orës së mësimi, mësuesi qëndron në klasë duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit.
- Mësuesi i arsimit fillor largohet nga institucioni vetëm kur klasa e tij mbaron procesin mësimor.
- Mësuesi i AMU-së dhe AML-së largohet nga institucioni vetëm me miratim të drejtorit të shkollës.

III. PËR PERSONELIN NDIHMËS

Sanitaret

- Personeli ndihmës paraqitet në institucionin arsimor në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës.
- Sanitaret të mbajnë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solucione dezinfektuese.
- Korridoret pastrohen çdo dy orë.
- Tualetet pastrohen e dezinfektohen çdo 30 minuta.
- Rezervuarëve të ujit që mund të ketë shkolla, u hidhet klor sipas udhëzimeve përkatëse çdo ditë.
- Dorezat e çdo klase dhe mjedisi pune si dhe parruket e shkollëve dhe vende të tjera pastrohen dhe dezinfektohen çdo 30 minuta.

- Largimi nga institucioni arsimor bëhet pas përfundimit të pastrimit dhe dezinfektimit të çdo mjedisi të tij.
- Kryen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mesuesit.

Roja i institucionit/oficeri i sigurisë

- Paraqitja në institucionin arsimor bëhet në orën e përcaktuar nga drejtoria e shkollës.
- Roja/oficeri i sigurisë të mbajë gjatë gjithë orarit të punës maskën, dorezat dhe solucione dezinfektuese.
- Roja nuk lejon prezencën e prindërve dhe çdo individ tjetër brenda në institucion (me përjashtim të nxënësve dhe personelit të deklaruar të institucionit arsimor).
- Çdo kërkesë për komunikim me drejtuesin e institucionit të bëhet nëpërmjet numrit të kontaktit të drejtorit ose të stafit drejtues.
- Kryen të gjitha detyrat duke respektuar distancimin social dhe fizik me nxënësit dhe mesuesit dhe sanitaret.

IV. PËR PRINDIN

- Nënshkruan ose konfirmon në rrugë elektronike, tek mësuesi, apo mësuesi kujdestar, këtë rregullore.
- Plotëson formularin e vetëdeklarimit ditor me përgjegjësi për gjendjen shëndetësore të fëmijës në numrin e kontaktit të mësuesit kujdestar.
- Në rast nevojë për komunikim me mësuesin, apo drejtuesin, përdor vetëm komunikimin elektronik.
- Në rastet e shoqërimit të fëmijës/fëmijëve në shkollë, nuk futet brenda mjedisit të shkollës për çfarëdo arsyeje që mund të paraqesë.

V. PËR DREJTUESIT

- Ngrenë grupe pune dhe hartojnë planet e veprimit për menaxhimin e situatës, garantimin e standardeve dhe respektimin e rregullave të përcaktuara më këtë rregullore.
- Monitorojnë pajisjen e nxënësve dhe të stafit me mjetet mbrojtëse, si: maskë, doreza, xhel dezinfektues për përdorim personal (sipas mundësive).
- Mbajnë kontakte, përmes komunikimit elektronik, me njësinë e vetëqeverisjes vendore, njësinë e mbrojtjes së fëmijëve, strukturat e Shëndetit Publik, Policinë e Shtetit dhe organet e tjera ligjzbatuese për ecurinë e procesit mësimor.
- Për çdo fëmijë i cili paraqet probleme shëndetësore, si p.sh rritje të temperaturës etj., apo ka njoftim nga prindi, ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, si dhe nëse

prindi përkatës është i sëmurë, apo ka patur kontakte me COVID-19, lajmëron menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.

- Për çdo mësues apo personel tjetër të shkollës, i cili paraqet probleme shëndetësore, si p.sh. rritje të temperaturës, etj., apo ka njoftim se ka patur kontakt me dikë të prekur me COVID-19, lajmëron menjëherë Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) dhe strukturën përkatëse në këto njësi.

DREJTOR

Albana FICO

